

22

Projekte modeluese muzikore-kreative me gjuhë

Qëllimi

Projektet pasuese u ndihmojnë nxënësve/eve në përkrahjen e kreativitetit të tyre. Ato bashkëdyzojnë aktivitetet muzikore dhe gjuhësore dhe çojnë tek produktet atraktive, ashtu që e përkrahin motivimin e tyre në mënyrë plotësuese.

1. Eksperimet me fluskat gjuhësore


kl. 2–9

15–20 min.



Materiali:
Fotografi të njerëzve nga gazetat ose revistat.

N zgjedhin një fotografi dhe mendohen se çfarë po mendon ose thotë personi vallë. Për këtë ata bëjnë një fluskë gjuhësore dhe e ngjitin mbi fotografi. Natyrish mund të modelohen edhe fluska gjuhësore humoristike.



Variante: dialogje-fluska gjuhësore tek fotot me më shumë se dy persona / piktura artistike në vend të fotove (Mona Lisa etj.) Smileys (emocione p.sh. ☺ ose ☹) në vend fotografi /kopje e një vizatimi komik, në të cilin M i ka fshirë fluskat gjuhësore me tippex; të vendoset vetë teksti, të krahasohet.

2. Të bëhet vetë një vizatim komik

kl. 2–7

30–60 min.



Materiali:
Për 2–4 N një jastëckë vule; letër.

M e sqaron rrjedhën: secili ekip dysh mendon së pari një tregim të vogël, i cili do të modelohet si pjesë komike (gjegjësisht tregim ilustrues) në 4–6 ilustrime. Në tregim do të duhej të paraqiteshin dy persona të cilët flasin njëri me tjetrin; këtu mund të paraqitet edhe një kafshë. Në vend që të vizatohen figurat do të stampohen trupat dhe kokat me pulpat e gishtërinjve. Krahët dhe këmbët do të plotësohen pastaj me vija. Kështu ndërtohen shpejt figura humoristike. Teksti do të vendoset në formë të fluskës gjuhësore.

Është mirë nëse paraprakisht janë shikuar tregime ilustruese ose pjesë komike, në mënyrë që N me format e teksteve dhe mundësitet e tyre të kenë më shumë vetëbesim. Shkallë zgjerimi: Krijimi i një fletushke me përbajtje komike. Kjo është veçanërisht nxitëse, nëse të gjithë N i zgjedhin të njëjtat figura kryesore përfletushkën me përbajtje komike (dhe si temë p.sh. episode nga vendi i prejardhjes).